



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

NJOFTIM PËR MEDIAT

1. Kërkuesi **Antonio Specchio** me datë **13.12.2024** ka paraqitur pranë Gjykatës kërkesën me objekt: “1. Realizimin e seancës gjyqësore për informim mbi gjendjen e proçedimit dhe verifikimi i kushteve të zbatimit të masës së sigurimit të dhënë ndaj shtetasit Antonio Specchio; 2. Revokimin e masës së sigurimit “arrest në burg” mbështetur në nenin 246/6, dhe 26/1 gërma “a” të K.Pr.Penale, ndaj Antonio Specchio”.

2. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me trup gjykues të përbërë nga gjyqtare Flora Hajredinaj, bazuar në nenet 228 e vijues, 246 pika 6 të K.Pr.Penale, me vendimin Nr. **727**, datë **23.12.2024**, vendosi:

1. Shqyrtimin në seancë gjyqësore të informacionit me shkrim, në lidhje me procedimin penal të filluar nr. 188 të vitit 2023, dhe gjendjen e zbatimit të masës së sigurimit për të arrestuarin **Antonio Specchio**.
2. Vazhdimin e zbatimit të masës së sigurimit “arrest në burg” të caktuar ndaj të hetuarit **Antonio Specchio**, të caktuar me vendimin nr.37, datë 10.04.2024, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, dhe rrëzimin e kërkesës për revokim apo zëvendësim të saj, si të pabazuar në ligj dhe në prova.
3. Një kopje e këtij vendimi të përkthehet në gjuhën italiane, dhe ti vihet në dispozicion të hetuarit **Antonio Specchio**.
4. Dega e financës të paguajë sipas rregullave financiare, përkthyesen e gjuhës italiane.
5. Kundër këtij vendimi lejohet ankim brenda 5 (pesë) ditëve, nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar në Gjykatën e Posaçme të Apelit, për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Tiranë, më datë 23.12.2024

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar